U D H Ë Z I M
Nr.12 datë 16.9.1993

PËR PROCEDURËN E DHËNIES SË TË DREJTËS TË STATUSIT ISH TË DËNUARVE DHE TË PËRNDJEKURVE POLITKË NGA SISTEMI KOMUNIST

Në zbatim të ligjit 7748, datë 29.7.1993, me propozimin e Komitetit të Ish të Përndjekurve politikë Këshilli i Ministrave

U D H Ë Z O N:

I. Paraqitja e dokumenteve nga i interesuari

1. Kërkesën për përfitimin e së drejtës së statusit mund ta bëjë çdo person që e ndien dhe mendon se ka arsye e prova të mjaftueshme për t'u cilësuar i përndjekur politik mbi bazën e përcaktimeve të këtij statusi.

2. Çdo person, i cili kërkon të drejtën e statusit, duhet të plotësojë dhe të paraqesë përveç dokmenteve që vërtetojnë përndjekjen, dhe këto dokumente:

a.certifikatën e gjendjes familjare

b. kartelën personale tip të hartuar nga Komiteti i Ish të Përndjekurve Politikë që i bashkëngjitet këtij udhëzimi:"

c. formularin me të dhëna ekonomiko-sociale që i bashkëngjitet këtij udhëzimi

3. Kartela personale tip për të drejtën e statusit mund të plotësohet edhe nga një person i tretë, kur:

a.personi i përndjekur në daten ë plotesimit të kartelës personale ka vdekur

b.vërteton ligjërisht se personi i përndjekur ka humbur zotësinë për të vepruar

c.personi i përndjekur për motive të ndryshme nuk ndodhet në Shqipëri në kohën e vlefshme për mbushjen e kartelës personale.

4. Personat që kërkojnë të drejtën e statusit për një person tjetër sipas rasteve të përshkruara në pikën 3 të këtij udhëzimi, detyrohen të paraqesin, përveç dokumenteve të detyrueshme për të gjithë, dhe këto dokumente:

- raport mjekësor
- certifikatë vdekje për personat që nuk jetojnë më
- vërtetim i noterizuar për vendbanimin e përhershëm a të përkohshëm për personat që nuk ndodhen në Shqipëri.

Personat që përmenden në këtë pikë, e firmosin vetë kartelën personale tip që i bashkëngjitet këtij udhëzimi.

5.Dokumentet që vërtetojnë persekutimin, sipas nenit 16 të statusit janë:"për pikën "a "

- Vërtetim i Komisionit të Ministrisë së Rendit dhe Ministrisë së Drejtësisë, kur personi është vrarë ose ka vdekur për shkak të përndjekjes:

raport mjekoligjor i kohës kur personi i përndjekur ka humbur gjykimin për shkak të përndjekjes, si dhe raport mjekoligjor i sotëm, me të cilin vërtetohet e kjo gjendje vazhdon edhe sot, ose deri në datën e vdekjes, kur i përndjekuri nuk jeton më. Shkalla e sëmundjes që përfiton të drejtat e pikës "a", përcaktohet nga një komision i ngritur posaçërisht për këtë qëllim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Në pikën "b"

- dëshmi penaliteti nga Ministria e Drejtësisë ose Komisioni i Posaçëm i Ministrisë së Rendit.
- vendim të gjykatave të sotshme që vërtetojnë kohëzgjatjen e qëndrimit në arati, në rastin e të arratisurve brenda vendit.

Për pikën "c"

- vendime të gjykatave ose të komisioneve të internim dëbimeve ose të Ministrisë së Rendit Publik.

Në pikën "d"

-Dëshmitë e personave të dënuar ose të internuar, shkaktare të përndjekjes së personave të tjerë, por jo më larg se nipi e se mbesa, në të dy kuptimet, si dhe çdo dëshmi tjetër dokumentare vendim gjykate ose jo, që vërteton përndjekjen e kujtdo për shkak të lidhjeve të tij farefisnore a shoqërore me persona të përndjekur që përfshihen në nenin 3, pikat " a, b, c" duke përfshirë edhe rastet që përshkruhen në nenin 6 të këtij ligji.

6. Nëse dokumentet origjinale që vërtetojnë përndjekjen mungojnë, mund të zëvendësohet me dëshmitë e komisionit të Ministrisë së Rendit Publik.

7. Për shkak të një personi të përndjekur sipas pikave " a, b dhe c" të nenit 3 të statusit quhen të përndjekur të gjithë pjestarët e tjerë të familjes së tij deri te nipi e mbesa, në të dy kuptimet sipas pikës "d" të nenit 3 të statusit duke pasur parasysh gjithnjë kufizimet e të gjitha pikave të nenit 5 të statusit. Në këtë kuptim çdo pjesëtar i familjes përfshirë në përcaktimin e mësipërm, ka të drejtë të plotësojë një kartelë personale për marrjen e statusit. Nga kjo e drejtë përjashtohen fëmijet dhe të rinjtë që kanë mbushur moshën 18 vjeç në datën 22.3.1992.

8. Personi përndjekja e të cilit nuk rrjedh nga përndjekja e përsonave të familjes që trajtohen në pikën 7 të këtij udhëzimi, ka të drejtë të paraqesë çdo dokument të kohës ku pasqyrohet një veprim ose mosveprim në dëm të interesave të tij socialekonomike,

të shoqëruar gjithmonë me një miratim të shoqatës së Ish të Përndjekurve politikë të rrethit ose të rajonit ku të shpjegohet se ky veprim a mosveprim ka qënë për motive politike dhe se qëndrimi i shtetit komunist ka qënë në vazhdim i diferencuar ndaj tij.

Kjo përndjekje që karakterizohet në pikën "d" të nenit 3 të statusit, mund të ketë rrjedhur për shkak të origjinës klasore a qëndrimit personal ndaj regjimit komunist.

9.Cilësim " kulak" do të trajtohet si një rast veçantë i pikës 8 të këtij udhëzimi. Dokumentet që do të vërtetojnë cilësimin " kulak" do të jenë ato të arkivave të ish komiteteve të Partisë së Punës , komiteteve ekzekutive të rretheve dhe Ministrisë së Financave. Në rastet kur këto dokumente mungojnë, çështja vërtetohet me gjyq. Të drejtën e pikës "d" të nenit 3 do ta pretendojnë të gjithë antarët e familjes së kryefamiljarit të shpallur " kulak" në datën e shpalljes dhe fëmijët që kanë lindur më vonë ose janë birësuar, si dhe fëmijët e fëmijëve, kur kanë lindur dhe kanë jetuar në fshat. Cdo person që kërkon të drejtën e statusit do të plotësojë një kartelë personale të shoqëruar me të gjitha dokumentet që kërkohen sipas pikës 2 të këtij udhëzimi dhe dokumentin që vërteton se është shpallur personalisht " kulak" ose dokumentet e kryefamiljarit të fotokopjuara e të noterizuara, shkaku i përndjekjes së tij.

II Procedura e dorëzimit dhe përcjelljes së dokumenteve deri në komisionin trepalësh.

10. Çdo person që plotëson dokumentet e nevojshme sipas këtij udhëzimi, i dorëzon ato në kryesinë e shoqatave të ish të përndjekurve politikë në rrethe, ose Shoqata të Ish të Përndjekurve Politikë dhe Ekonomikë (për rastin e kulakëve).

Kryesitë e këtyre shoqatave ia dorëzojnë të numëruara dhe me shkresë përcjellëse inspektorit të ish të përndjekurve politikë në rreth. Për shqyrtimin dhe klasifikimin paraprak të kërkesave krijohet një komision prej 5 vetash në rrethe (për Tiranën në rajone) i cili përëbëhet nga:

a.kryetari i shoqatës të ish të përndjekurve politikë.

b. dy antarë të shoqatës të ish të përndjekurve politikë

c.kryetari i shoqatës së të përndjekurve ekonomikë

ç inspektori i ish të përndjekurve politikë (kryetar)

Të gjithë dokumentet me vërejtjet e bëra nga komisioni i përcillen drejtorisë së statusit dhe të ligjeve në Komitetin e ish të Përndjekurve politikë.

11. Drejtoria e Statusit dhe e ligjeve ka këto të drejta:

a. verifikon dokumentet nga pikëpamja formale

b.verifikon vlefshmërinë ligjore mbi bazën e kërkesave të statusit.

c. bën klasifikime sipas grupeve.

ç. përcakton ditët e dënimit për kompensimin pasuror për pikat " b" dhe " c" të nenit 3 të statusit, duke plotësuar vërtetimin që i bashkëngjitet këtij udhëzimi.

Pas përfundimit të këtij procesi dokumentet i dërgohen komisionit trepalësh.

12. Komisioni trepalësh i shqyrton dokumentet një nga një dhe nxjerr vendimin për dhënien e statusit për çdo mbledhje të tij.

Në rast se komisioni trepalësh vë në dyshim marrjen e statusit nga një person tjetër për efekte të kufizimeve të nenit 5 të përpara se të vendosë mund të thërrasë personin për sqarim dhe dokumentim të çështjes. Sipas përbërjes së komisionit trepalësh një kopje e listës së kërkesave që miratohen mbahen në Ministrinë e Drejtësisë, një kopje në Komitetin e Ish të përndjekurve Politikë. Dokumentet për dhënien e statusit arkivohen nëKomitetin e ish të Përndjekurve Politikë.

13. Në zbatim të nenit 18 të ligjit për statusin Komisioni trepalësh merr në shqyrtim në raste të veçanta që përjashtohen për efekt të nenit 5 të ligjit nga e drejta e statusit, me propozim të Shoqatës Kombëtare të ish të Përndjekurve Politikë dhe vendos përfundimisht për dhënien ose jo të së drejtës së statusit.

14. Drejtoria e statusit dhe e ligjeve për Komitetin e Ish të Përndjekurve Politikë mbi bazën e vendimeve të komisionit trepalësh, lëshon vërtetimin për njohjen e statusit për shkallët e specifikuara në ligjin për dhënien e statusit, si dhe ditët që njihen për kompensim pasuror, pasi të vlerësohen në lekë. Listat e fituesve afishohen në rrethet përkatëse. Forma e vërtetimit që konfirmon dhënien e statusit sipas shkallës së përcaktimit i bashkëngjitet këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

REPUBLIKA E SI
KOMITETI I ISH TE PERNDJEKURVE POLITIKE
ZYRA E INSPEKTORIT TË RRETHIT _____

KARTELË PERSONALE

Drejtuar Komisionit Shtetëror për dhënien e Statusit.
Unë i nënshkruari _____ i datëlindjes _____
lindur më _____ Nr.letërnjoftimi _____
mendoj se përsa parashtroj, më takon statusi i të përndjekurit politik.

Shkaku i përndjekjes

1. Humbja e jetës ☐
2. Humbja e aftësisë mendore ☐
3. Burgim ☐
4. Internim ☐
5. Dëbim ☐
6. Kulak ☐
7. Deklasuar ☐
8. Shkaqe të tjera ☐

---

1. Kërkuesi i këtij statusi rron ☐
2. Kërkuesi i këtij statusi nuk rron ☐

Përgjegjësi i të përndjekurve politikë

Përndj.politik
Kryetari i shoqatës
Kulakëve

Personi kërkues

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I ISH -TË PËRNDJEKURVE POLITIKË

TË DHËNA PËR GJENDJEN SOCIALEKONOMIKE TË ISH-TË PËRNDJEKURVE POLITIKË

Unë i nënshkruari ..... për sa i perket gjendjes sime socialekonomike, deklaroj sa më poshtë vijon:

1. Datëlindja ..... Vendlindja .....
2. Qendra e banimit (fshat.qytet).....
3. I sistemuar (po/jo) .....
4. Ka tokë në pronësi (po/jo).....
5. Ka pronësi në qytet (po/jo) .....
6. I punësuar në sektorin (privat/shtetëror) .....
7. Gjendja sociale (asistencë/ndihmë ekonomike/ pension invaliditeti).....
.....
8. Seksi (femër/mashkull) .....
9. Profesioni .....
10. Arsimi (i lartë/i mesëm/i ulët) .....
11. Shkaku i persekutimit (i dënuar/ i internuar/ kulak etj.)
.....
12. Gjendja familjare (i martuar/beqar/i divorcuar).....
.....
13. Fëmijët deri në 18 vjeç .....

Firma

Shënim : Ky formular plotësohet nga kryefamiljari.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I ISH-TË PËRNDJEKURVE POLITIKË
(Drejtoria e Ligjeve dhe e Dhënies së Statusit)

VËRTETIM PËR DHËNIE STATUSI

Në bazë të vendimit nr._____, datë _____ të komisionit trepalësh, ku jepet e drejta e statusit sipas nenit 3, pika _____ Numri i ditëve që përfiton kompensim pasuror _____.

DREJTORI